



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:017711
Datë: 15.12.2023
Numri i dokumentit: 05070347

PA1.nr. 240/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Skender Çoçaj, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarit I.A., nga fshati ...,K. Kline, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së të akuzuarit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega ne Klinë, P.nr. 29/2021 të datës 02.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12 Dhjetor 2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit I.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega ne Klinë, P.nr. 29/2021 të datës 02.02.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Pejë – Dega ne Klinë, P.nr. 29/2021 të datës 02.02.2023, i akuzuari I.A., është shpallur fajtor për shkak të veprës Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj me kusht se i njëjti dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) viteve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër vepër penale.

I akuzuari është obliguar që të paguaje shpenzimet e procedurës penale të cilat dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 30 (tridhjetë) euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara KEDS për realizimin e kërkesave tjera eventuale pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

I akuzuari I.A., për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe shkeljes se ligjit penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare te ndryshohet dhe i akuzuari ne mungese te provave te lirohet nga akuza apo aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosije.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit I.A., me shkresën e vet PPA.II.nr. 280/23 të datës 22.02.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e te akuzuarit ta refuzoje si te pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës se shkalles se pare te vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, ne te cilën prezantoi vetëm i akuzuari I.A., ndërsa palët e tjera munguan, andaj seanca e kolegjit u mbajt ne pajtim me nenin 390 paragrafi 4 te KPPRK-se. I akuzuari në tërësi mbeti pranë ankesës së ushtruar me shkrim dhe pas elaborimit të së njëjtës propozoi që ankesa të aprovohet si e bazuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të akuzuarit I.A., dhe gjeti se :

- Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i Gjykatës se shkalles se pare nuk është atakuar lidhur me bazën ankimore shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale, Gjykata e Apelit e vlerësoi edhe ne këtë aspekt dhe konstatoi se i njëjti nuk është i përfshire me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale te natyrës absolute e te cilat Gjykata e Apelit i konstaton sipas detyrës zyrtare, e te cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit.

Sa i përket vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, i akuzuari me ankesë pretendon se gjykata e shkalles se pare nuk e ka vërtetuar drejte dhe ne mënyre te plote gjendjen faktike kur te njëjtin e ka shpallur fajtor ngase ngase nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor, siç është pretenduar në aktakuzë e që këto fakte nuk janë vërtetuar as pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve andaj gjykata të akuzuarin e ka shpallur fajtor pa u plotësuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor ngase i njëjti eshte kyqur ne rrjetin e energjisë elektrike nga arsyeja se disa here ka kërkuar nga KEDS që të kyqet ne rrjetin e energjisë elektrike mirëpo eshte udhëzuar qe te shkojë ne Pejë ndërsa as atje nuk ka mundur të kryej punë për çka është detyruar qe ta kyqë vet rrymën.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të të akuzuarit lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase janë ne kundërshtim me provat e administruara si : dëgjimi i dëshmitarit Shefket Gashi i cili ka deklaruar se me rastin e kontrollimit tek konsumatori tani i akuzuari

I.A. është konstatuar se i njëjti ka qenë duke e keqpërdorur energjinë dhe i lidhur direkt ne rrjetin elektrik dhe i njëjti kabëll e ka furnizuar shtëpinë e konsumatorit dhe atë jashtë njehsorit pra direkt ne rrjet si dhe provave materiale si procesverbali me numër 2365574 i datës 10.02.2020, fatura mbi dëmin e shkaktuar e datës 12.02.2020, procesverbali i datës 13.03.2020, procesverbali i datës 24.06.2020, fatura mbi dëmin e shkaktuar e datës 29.06.2020 dhe e datës 17.03.2020 si dhe foto dokumentacioni e ne baze te te cilave konstatohet se Gjykates se shkalles se pare, drejte dhe ne menyre te plote ka vërtetuar gjendjen faktike ne rastin konkret, andaj edhe pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike i refuzoi si te pabazuara si dhe konstatoi se ne rastin konkret kur i akuzuari është shpallur fajtor per veprën penale për të cilën është akuzuar, drejte është aplikuar edhe ligji penal, per çka është pretendimet e të akuzuarit lidhur me shkeljen e ligjit penal në dëm të të akuzuarit i refuzoi si të pabazuara ngase ne veprimet e te akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive te veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, per te cilat është shpallur fajtor dhe gjykuar.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, i akuzuari, me ankesë nuk e atakon aktgjykimin lidhur me kete baze ankimore ngase pretendon se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale dhe se i njëjti duhet te lirohet ne mungesë të provave, megjithatë Gjykata e Apelit e vlerësoi edhe ne këtë aspekt dhe konstatoi se gjykata e shkalles se pare me rastin e vendosjes ne lidhje me sanksionin penal ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese te parapara me nenin 69 dhe 70 te KPRK-se e te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, me bindje se me dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerëses nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i saj, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.240/23 më 12.12.2023

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Zyhdi Haziri

Skender Çoçaj